

# Buxhetimi me të drejta dhe detyrime të konstatuara: të papriturat negative

1

**GERT VAN DER LINDE**  
**KRYE-SPECIALIST PËR MFP**  
**PULSAR / FINCOP**  
**10 KORRIK 2018**

# Struktura

2

Konstruktet e sistemit të buxhetit me bazë monetare të qeverisë

Atëherë, çfarë është buxheti me të drejta dhe detyrime të konstatuara?

Çfarë do të ishin ishte e ndryshme?

A nënkupton medoemos kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara kalim drejt buxhetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara?

Disa përfitime nga buxhetimi me të drejta dhe detyrime të konstatuara

Aspekte të tjera të politikës dhe menaxhimit fiskal, për t'u mbajtur parasysh

Disa probleme me të dhënat

Diskutim

# Konstruktet e sistemit të buxhetit me bazë monetare të qeverisë

3

## Buxheti duhet të sigurojë:

- Qëndrueshmëri fiskale; dhe
- Stabilitet fiskal (nxitje të stabilitetit makroekonomik nëpërmjet menaxhimit të ndikimit financiar të operacioneve qeveritare)

Shqetësim kryesor – deficit vjetor në flukset monetare, efekti që ka në borxh dhe qëndrueshmëria e politikave tatimore dhe të shpenzimeve

Politikat e zgjedhura → rrjedhojat për të ardhurat, shpenzimet dhe borxhin

Autoriteti shpenzues (kufizimet) → miratimi i buxhetit me ligj

Zbatimi i buxhetit → Kontrolli i shpenzimeve i ndjek pagesat kundrejt limiteve të vendosura në ligj

Skadimi vjetor i autoriteteve shpenzuese

# Atëherë, çfarë është buxheti me të drejta dhe detyrime të konstatuara?

4

Me të drejta dhe detyrime të konstatuara = në thelb për të llogaritur ndikimin financiar të transaksioneve / ngjarjeve kur ndodhin, dhe jo kur hyjnë a dalin flukset monetare

Nuk është term buxhetor normal nga këndvështrimi i menaxhimit financiar - madje edhe përgatitja e një buxheti të mirë të flukseve monetare do të varej nga informacionet me të drejta dhe detyrime të konstatuara

A duam të themi buxhet “shfrytëzimi” (sipas gjuhës normale të menaxhimit financiar)? Nëse po -

- Kontrolli i shpenzimeve tani duhet t'i ndjekë shpenzimet me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe jo sipas flukseve monetare; dhe
- Çdo deficit që rezulton nuk mund të interpretohet më si deficit i flukseve monetare, por vetëm si matje e shkallës se deri ku të ardhurat i mbulojnë kostot e shfrytëzimit (përfshirë kostot e lindura sot, por jo të paguara).

# Çfarë do të ishte e ndryshme?

5

Kontrollet e shpenzimeve tani ndjekin shpenzimet me të drejta dhe detyrime të konstatuara - p.sh.

- llogaritë e pagueshme për mallrat/shërbimet e marra
- inventari i përdorur llogaritet si shpenzim, pavarësisht nga kur është blerë
- amortizimi i aktiveve të qëndrueshme etj.

Zëra të tillë “të rinj” të shpenzimeve duhet të buxhetohen, të kufizohen sipas nevojës dhe të miratohen me ligj

Buxheti nuk paraqet më një deficit/suficit monetar

Mund të duket sikur humbet kontrolli i drejtpërdrejtë mbi rezultatet monetare

Monitorimi pas faktit i llogarive të ministrive bëhet jashtëzakonisht i rëndësishëm

A duhet të mbulohen me fonde shpenzimet jo monetare (si amortizimi)?

# A nënkupton medoemos kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara kalim drejt buxhetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara?

6

- A do të thotë të pasurit e një bilanci dhe një pasqyre të ardhurash se nuk kemi nevojë për një buxhet apo masa kontrolluese të flukseve monetare?
- Jo
- Opsionet:
  - Vijohet me miratimin dhe kontrollimin sipas bazës monetare dhe raportohen shpenzimet monetare vetëm në raportin e zbatimit të buxhetit (d.m.th. jo në "pasqyrën e performancës financiare")
  - Përfshihet shpenzimet jo monetare në buxhet, por nuk miratohen mjete monetare për to - buxheti do të paraqiste kostot e plota të konstatuara dhe mjetet monetare të nevojshme. Mirëpo, po zëra të tillë si zhvlerësimi i akumuluar? A kthehet kjo në një "të drejtë për shpenzime kapitale"?
  - Apo duhet të mbulohen me fonde shpenzimet jo monetare, me kontroll mbi përdorimin që u bëjnë Ministritë suficiteve monetare? Dhe si do të trajtohen blerjet kapitale?

# Disa përfitime nga buxhetimi me të drejta dhe detyrime të konstatuara

7

**Përputhja e të ardhurave dhe shpenzimeve për të përcaktuar më saktë koston e vënies në shfrytëzim të qeverisjes**

**Përmirësimi llogaritjes së koston së shërbimeve / produkteve**

**Përmirësimi i menaxhimit të aktiveve dhe kapitalit qarkullues (debitorët, kreditorët, inventari)**

**Pamje më e mirë mbi ndikimin që kanë vendimet te qëndrueshmëria afatgjatë e financave publike**

**Katalizator për reformat e menaxhimit me bazë performancën**

# Aspekte të tjera të politikës dhe menaxhimit fiskal, për t'u mbajtur parasysh

8

## Pikëpamjet për llogaridhënien

- Të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet
- Performancë e realizimit të shërbimeve
- Kontrolli mbi subjektet publike

## Trajtimi i pasiveve dhe aktiveve “të reja” financiare, inventarit dhe aktiveve afatgjata materiale

- zhvillohen politikat e nevojshme kontabël
- konstatohet ndikimi të situata fiskale të pasiveve dhe aktiveve financiare, inventarit dhe aktiveve afatgjata materiale të raportuara rishtazi
- shqyrtohet llogaridhënia aktuale dhe hartohen rregullore për menaxhimin financiar të pasiveve dhe aktiveve financiare, inventarit dhe aktiveve afatgjata materiale të raportuara rishtazi
- hartohet një kuadër i menaxhimit të pasiveve financiare për subjektet publike, fondet e tjera të krijuara me ligj dhe sferat e tjera të qeverisjes



# Aspekte të tjera të politikës dhe menaxhimit fiskal, për t'u mbajtur parasysh

9

**Ruajtja e fokusit te bilanci fiskal në kohë duke i kufizuar deficitet monetare**

**Qartësi dhe kujdes me matjet e “deficitit”**

- Deficiti monetar mat aftësinë për të financuar të gjitha shpenzimet monetare të një viti financiar me të ardhurat monetare të siguruara në të njëjtin vit financiar (nevoja për financim neto)
- Deficiti me të drejta dhe detyrime të konstatuara mat koston vjetore të shfrytëzimit, përfshirë kostot që lindin sot që paguhen në të ardhmen

**Mendohet interpretimi dhe udhëzohet përdorimi i të paktën masave të reja të mëposhtme për subjektet buxhetore të konsoliduara -**

- borxhi neto (aktivet financiare minus pasivet financiare);
- ndryshimi i borxhit neto nga viti në vit;
- suficiti / deficiti në Pasqyrën e Performancës Financiare; dhe
- suficiti / deficiti i akumuluar

**Mendohet interpretimi dhe udhëzohet përdorimi i matjeve të reja edhe për llogaritë e konsoliduara**

# Disa probleme me të dhënat....

10

Gjeni mënyra për të minimizuar koston e lidhur me marrjen e të dhënave të bilancit të çeljes për aktivet afatgjata materiale dhe infrastrukturat e tjera.

SNKSK – nuk është e nevojshme të përmbushen kërkesat për dhënie të informacioneve shpjeguese nëse informacioni nuk është material

Të zhvillohen politika kontabël për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë, gjë që mund të kërkojë që për disa kategori të aktiveve të qëndrueshme, siç janë pajisjet që zhvlerësohen plotësisht gjatë periudhës së grumbullimit të të dhënave, nuk kërkohen të dhëna për koston historike dhe qeveria mund të fillojë t'i kontabilizojë këto aktive duke filluar nga një datë e ardhshme.

Për klasat e tjera të aktiveve afatgjata materiale, SNKSP 17 gjithashtu përcakton se duhet të njihen si aktiv vetëm nëse: (i) ka shumë mundësi që njësisë ekonomike do t'i vijë përfitime ekonomike të ardhshme ose potencial i shërbimit i lidhur me zërin; dhe (ii) kostoja ose vlera e drejtë e zërit mund të matet në mënyrë të besueshme.

Gjeni kompromiset dhe bini dakord për qasjen me Audituesin e Përgjithshëm (Këshillin e Lartë të Shtetit)

# Faleminderit p r koh n!

11

PYETJE?